




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality Skenderaj

### Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverballi i mbledhjes së KOMITETI PËR POLITIK E FINANCAT, i mbajtur me datë 20.06.2024, në ora 11:00, në sallën e bordit të drejtoreshave.

#### **Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2025-2027, dhe Raporti i Kryetarit të Komunës mbi ecurinë e dëgjimeve buxhetore për KAB-in, me Nr.04-052/01-0027698/24, të datës 13.06.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z.Ismet Aliu**);
5. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj, (Raporton drejtoresha e DSHMS-së, **znj.Rrezarta Hasani-Ibrahimi**);
6. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planin Lokal për Transportin Rrugor 2024-2028, në komunën e Skenderajt, (Raporton drejtori i DSHP-së, **z.Alban Shala**);
7. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Rregullores Komonale për kushtet dhe mënyrat e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë në komunën e Skenderajt, (Raporton drejtori i DSHP-së, **z.Alban Shala**);
8. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planit të veprimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në komunën e Skenderajt 2024-2027, (Raporton drejtoresha e DZHENIT-së, **znj.Besarta Meha-Ademi**);
9. Të ndryshme.

**Kryesuesja:** Të nderuar anëtar KPF-së, kryetar i komunës, drejtor të drejtorive, në këtë mbledhje i kemi 5 anëtarë të KPF-së, mungon me arsye Alketa Mecini.

-Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi i ditës së bashku me 5 pikat shtesë.

-Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

-Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2025-2027, dhe Raporti i Kryetarit të Komunës mbi ecurinë e dëgjimeve buxhetore për KAB-in, Nr.04-052/01-0027698/24, dt. 13.06.2024, (Raporton

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** Fjala përshëndetëse, Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2025-2027, është një dokument paraprak i buxhetit final i cili duhet të aprovohet në shtator të këtij viti për vitet e ardhshme i prodhuara nga të gjitha objektivat e të gjithë drejtorive dhe zyrave, bazën ligjore e ka nga qarkorja buxhetore 2025/01 në të cilët identifikohen të gjitha burimet e komunës, të cilët financohen për vitin 2025-2027, materialin e keni pas me kohe, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

**Kryesuesja:** E hap debatin, fjalën ja kaloj:

**Mentor Mehmeti-PDK:** Fjala përshëndetëse, drejtor e kam pa të arsyeshme me bë një propozim të DKRS-ja, me shtua një pikë, që me parapa në monumente kulturore buste varreza, me bë me qerek kod, në mungesë të ciceronëve, që përmes telefonit me identifikuva historinë e ati busti apo varreze, së di sa ka implikime buxhetore, po propozoj që me u vendos kjo?

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** Faleminderit për propozim Mentor, sa i për këtë implikimeve buxhetore çdo drejtor i drejtorive ka të drejtë me i parapa shpenzimet e sakta të veta, përveç shpenzimeve të sakta që i bartë një kod ekzistues, d.m.th. drejtori me i bë kërkesat e sakta për çdo lloj të shpenzimit brenda asaj kategorie mallra e shërbime, ne jemi të obliguar me i nda neper nënkategori neper nën programe që është shume me e letë edhe menaxhohet edhe buxheti, po tash është në dorën e drejtorit të kulturës, apo drejtorëve tjerë.

**Kryesuesja:** dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (4) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2025-2027, dhe Raporti i Kryetarit të Komunës mbi ecurinë e dëgjimeve buxhetore për KAB-in, Nr.04-052/01-0027698/24, dt. 13.06.2024.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e Draft-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj, (Raporton);

**Drejtoresha e DSHMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi;** Fjala përshëndetëse, me kërkesë të ministrisë së shëndetësisë në të gjitha institucionet e kujdesit parësorë shëndetësorë, që nuk e kanë të aprovuar formën unike të statutit të QKMF-së duhet të aprovohet sa me shpejtë, pasi që edhe do të jetë një prej indikatorëve që do të monitorohet nga ministria e shëndetësisë përgjatë vitit 2024, materialin e keni pas me kohe, jam këtu për çdo përgjigje.

**Kryesuesja:** E hap debatin, fjalën ja kaloj:

**Mentor Mehmeti-PDK:** Drejtoresha është kjo kërkesë për të gjitha komunat, së ne njëherë e kemi votuar statutin e QKMF-së, a është i njëjti a po ka ndryshuar diçka, sepse unë e kam lexuar nuk ka diçka ndonjë ndryshim?

**Drejtoresha e DSHMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi;** Është kërkesë e ministrisë së shëndetësisë, që statuti të jetë unik, në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare në Kosovë, dhe është dashur me i bë disa ndryshime të vogla.

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (4) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për miratimin e Draft-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planin Lokal për Transportin Rrugor 2024-2028, në komunën e Skenderajt, (Raporton);

**Drejtori i DSHP-së, Alban Shala;** Fjala përshëndetëse, para vetes e keni pas me kohe Planin Lokal për Transportin Rrugor 2024-2028, në komunën e Skenderajt, plani i ka përfundua diskutimin publik, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

**Kryesuesja:** E hap debatin, fjalën ja kaloj:

**Mentor Mehmeti-PDK:** E kam lexuar tërësisht këtë Planë, po mungesat e mëdhaja i ka të personat me aftëso të kufizuar, asnjë automjet, as një taksi nuk është në qytet që me i shfrytëzua këta persona, vetëm janë të varur krejt prej familjareve, dhe propozoj që me i kushtëzua firmave të taksistëve që me pas një automjet për persona me aftësi të kufizuar, së ne disa qytete tjera ka? Edhe në disa unaza të transportit publik nëse ish kanë e mundur me pas një lidhshmëri për me u zbrazë qyteti prej automjeteve që vinë në punë personat, e mos mi lënë veturat neper trotuar?

**Drejtori i DSHP-së, Alban Shala:** Shume vërejtje me ven, nëse ka mundësi, prej auto taksave do të punoj në këtë drejtim dhe kemi me bë, dhe çështja e transportit kemi me u marr e me lehtësua punën me transport publik.

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planin Lokal për Transportin Rrugor 2024-2028, në komunën e Skenderajt.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e Draft-Rregullores Komunale për kushtet dhe mënyrat e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve me automerimangë në komunën e Skenderajt, Raporton;

**Drejtori i DSHP-së, Alban Shala;** Para vetes e keni Rregullores Komunale për kushtet dhe mënyrat e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë në komunën e Skenderajt, kërkesë ka qenë nga Policia e Kosovës, konkretisht nga Drejtoria rajonale e Mitrovicës drejtuar kryetarit për hartimin e kësaj rregullore, rregullorja ka kaluar nëpër diskutim publik, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

**Kryesuesja:** E hape debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (4) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për miratimin e Draft-Rregullores Komunale për kushtet dhe mënyrat e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë në komunën e Skenderajt.

Vazhdojmë me piken 8 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planit të veprimit për punësimin e peronave me aftësi të kufizuar në komunën e Skenderajt 2024-2027, (Raporton;


**Drejtoresha e DZHENIT-së, Besarta Meha-Ademi;** Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Planit të veprimit për punësimin e peronave me aftësi të kufizuar në komunën e Skenderajt 2024-2027, ky planë është punuar nga Handikos dhe u mbështet nga disa drejtori komunale dhe një numër të organizatave të shoqërisë civile, është financuar nga UNDP, dhe komuna e Skenderajt, materialin e keni pas me kohe, jam këtu për çdo përgjigje.

**Kryesuesja:** E hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planit të veprimit për punësimin e peronave me aftësi të kufizuar në komunën e Skenderajt 2024-2027,

Vazhdojmë me piken 9 të rendit ditës:

Të ndryshëm, a ka dikush me shtua diçka, nëse nuk ka, me qaq e mbyllim këtë mbledhje shihmi në seancë e kuvendit, për datë dhe ore ju njoftojmë me kohe, gjitha të mirat

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit